

KËRKESË

për qasje në informacione të karakterit publik

Në bazë të neneve 4 dhe 12 të Ligjit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 13/06, nr.86/08, nr.6/10.42/14, nr.148/15 dhe nr. 55/16), kërkoj nga poseduesi informatat me karakter publik si në vijim:

Dokumentet që lidhen me ndërtimin e krahut të R2239 në drejtim të lëvizjes nga shkëputja nga A4 (kthesa djathtas) deri në lidhjen e krahut të R2239.

Lënda: Përgjigje ndaj Kërkesës për qasje në informacione të karakterit publik

Lidhur me kërkesën tuaj për qasje në informacione të karakterit publik, ju njoftojmë se në Sektorin për mirëmbajtje pranë Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore nuk ka dokumentacion për rikonstruimin e rrugës R2239, Stenkovec (kryqëzimi me A4) - Brodec - Tanushevc. Gjegjesisht, në Programet e Mirëmbajtjes 2018 dhe 2019, fondet për përmirësimin e korsisë parashikohen dhe zbatohen nga Ndërmarrja Publike për Mirëmbajtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale (Makedonijapat), por bëhet fjalë për mirëmbajtje me një përmirësim të thjeshtë të korsisë (zëvendësimi i shtresës së sipërme të asfaltit), prandaj nuk ka dokumentacion teknik për zëvendësimin e shtresës së asfaltit.